



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1484 Prot.

Tiranë, më datë 12. 10.2021

VENDIM
Nr. 609, datë 12.10.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.10.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ndërhyrje arkitektonike – Ndërtesë dy katëshe”, brenda kufirit të Zonës së Mbrojtur të Qendrës Historike të qytetit të Shkodrës, me aplikues Z. Ruzhdi Dibra, projektues restaurator znj. Shpresa Prifti, zhvillues z. Jetmir Lekaj;
2. Në zbatim të Vendimit të Ministrave Nr. 771, datë 30.09.2020 “Për deklarimin Pasuri Kulturore të “Qendrës Historike” të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e Zonës Mbrojtëse të saj dhe miratimin e Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre”, Neni 11, Pika 4:
 - Zbatimi i punimeve të kryhet nga subjekte të licencuara për këtë kategori;
 - Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK Shkodër;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

